



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 15 maj 2024
Ceremonia e lamtumirës për punonjësin e Policisë së Shtetit, Inspektor Novruz Cenalia
Tiranë – Njoftim mbi veprimet procedurale të Policisë, pas protestës së datës 14.05.2024
Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit
Durrës – Vihet në pranga 1 shtetas dhe shpallet në kërkim djali i tij, për 1 plagosje me armë zjarri



Lajmet

15/05/2024

Durrës – Informacion Shtesë Për Arrestimin E Shtetasit A. M.

Në lidhje me ngjarjen e ndodhur rreth orës 02:30, të datës 15.05.2024, në zonën e quajtur “Shkëmbi i Kavajës”, ku shtetasi A. M., 40 vjeç, banues në Lezhë, u neutralizua nga shërbimet “RENEA”, në bashkëpunim me ato të Policisë së Durrësit, pasi mbajti peng 2 fëmijët e tij të mitur (6 dhe 11 vjeç), në një apartament të marrë me qira, dhe qëlloi nga dritarja me armë zjarri kallashnikov, ju infomojmë se:

Pas shoqërimit të tij në ambientet e Policisë, u kryen veprimet procedurale dhe në përfundim të tyre u bë arrestimi në flagrancë i 40-vjeçarit, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Heqja e paligjshme e lirisë”, “Shkatërrimi i pronës”, “Prishja e qetësisë publike” dhe “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Në vijim, lidhur me rrethanat e kësaj ngjarjeje, ju informojmë se shërbimet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, më datat 14.12.2023 dhe 27.03.2024, kanë referuar në Prokurori, kërkesat për lëshimin e menjëhershëm të urdhrit të mbrojtjes për bashkëshorten e shtetasit A. M., shtetasen B. M., 32 vjeçe. Në asnjërën nga seancat, 32-vjeçarja nuk është paraqitur në Gjykatë.

Gjithashtu, përsa i përket gjendjes penale të shtetasit A. M., ju informojmë se pas verifikimeve ka rezultuar se në Itali, ka thyer masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, të caktuar për veprën penale “Vjedhja”.

Në drejtimin e Prokurorisë së Durrësit, grupi hetimor vijon hetimet dhe veprimet procedurale, për të përcaktuar nëse 40-vjeçari ka qenë në efektin e lëndëve psikotrope, gjatë ngjarjes, si dhe për të dokumentuar me prova të ligjshme, rrethanat e tjera të këtij rasti.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Durrës – Qëlloi me armë zjarri nga banesa ku mbante peng 2 fëmijët e tij të mitur, arrestohet nga RENEA

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, gjatë 24 orëve të fundit ▶